



2.05 - Lidershipi si luan

(2.05 - Lion Hearted Leadership)

1. Mësimet që mund të mësohen nga luani - një shembull i vërtetë i lidershipit.

(Shkrimet nga ALBB)

Cila është gjëja e parë që të bie ndërmend kur shikon ose dëgjon për një luan? A është forca e tij? A është egërsia dhe guximi i tij? A është hungërima e tij mbretërore dhe madhështore? Apo është pamja e tij madhështore? Çfarëdo që të dish për luanin, duhet ta pranosh që ai është një kafshë e veçantë, në fakt është kaq e veçantë sa që quhet edhe "Mbreti i xhunglës" (edhe pse më së shumti gjendet në kullota). Luani si një kafshë nga i cili duhet të mësojë çdo drejtues dhe udhëheqës ambicioz. Për këtë arsye kam zgjedhur pesë fakte rreth luanëve dhe mësimet që mund të mësosh prej tyre.

FAKTI 1: Një ulërimë luani mund të dëgjohej nga tetë kilometra larg

MËSIMI 1: Bëj që të të dëgjojnë.

- Është e rëndësishme që të të dish se deklaratat që bën nuk janë vetëm për atë që thua, gjërat që bën dhe karakteri yt është pjesë e asaj që përbën reputacionin tënd.
- Luani e di se hungërima e tij e paraprin atë kudo që shkon, prandaj ajo është edhe kulmi i guximit.
- Nëse e zhvillon reputacionin tënd ashtu siç duhet (në Krishtin), guximi yt do të rritet.

FAKTI 2: Luanët janë kafshë shumë sociale; ata formojnë grupet e quajtura tufë luanësh me ndonjëherë dyzet kafshë në një tufë:

MËSIMI 2: Ndërvepro me të tjerët në mënyrë që të përmirësohesh

- "Mos ndërto fortësia për të mbrojtur veten - izolimi është i rrezikshëm".
- Shumë njerëz besojnë se detyra e udhëheqjes është një barrë që nuk mund të ndahet - jo plotësisht e vërtetë.
- Lideri duhet ta shohë veten si një lumë që ushqen të tjerët dhe që nga ana tjetër ushqehet nga të tjerët.
- Një lumë që izolon vetveten, që nuk ushqen asgjë dhe që vetë nuk ushqehet nga asgjë, herët a vonë do të fillojë të vijë erë e keqe ose të thahet.
- Mos harro akronimin e famshëm **TEAM (Together Everyone Achieves More - Së bashku secili arrin më shumë)**.

FAKTI 3: Një luan mund të kalojë deri në 20 orë në ditë duke fjetur:

MËSIMI 3: Ka dallim midis një lideri dhe një skllavi, gjej kohën për t'u çlodhur.

- Ne jemi të tunduar të punojmë dhe të punojmë si skllavë, ne jemi vazhdimisht të raskapitur dhe të lodhur, dhe përsëri nuk e shohim nevojën për t'u çlodhur.
- Mëso nga luani, i cili e di se çdo ditë duhet të hajë, e megjithatë fle më shumë se gjysmën e ditës. Pavarësisht nga kjo papërgjegjshmëri në dukje, luani nuk mbetet kurrë i uritur.
- "Mendjet tona kanë nevojë për çlodhje, dhe me punën duhet të përzihet edhe një lojë e vogël".
- Nëse do të kesh një jetë të gëzuar, mëso të mos lejosh që aktiviteti të dominojë jetën tënde. Gjej kohë për t'u çlodhur.



2.05 - Lidershipi si luan

FAKTI 4: Luanët rrallë e hanë të gjithë prenë, zakonisht lënë pas mbetje për kafshë të tjera si hijenat dhe hutat:

MËSIMI 4: aftësia për të ndarë është shenjë dalluese e një lideri

- Çdo lider ka njerëz që e ndjekin atë dhe është detyra e atij lider të sigurojë që këta ndjekës të marrin një shpërndarje të drejtë të çdo përfitimi që i bëhet organizatës.
- Të jesh një lider nuk është vetëm aftësia për të dhënë urdhra ose për të ndarë punën, por është edhe aftësia për të motivuar.
- Nuk ka asgjë që mund të motivojë si shpërblimi dhe stimujt, një lider i vërtetë nuk i kursen këto gjëra.
- Nëse do të respektohesh duhet të mësosh të japësh lirisht nga vetja jote tek të tjerët.
- Është e vështirë të imagjinohet që luani, pavarësisht oreksit të tij të pangopur dhe sasisë së ushqimit që i nevojitet për të kënaqur nevojat e trupit masiv, është ende mjaft i vëmendshëm për të lënë mbetje për të tjerët.

FAKTI 5: Luanët meshkuj mbrojnë territorin e krenarisë ndërsa femrat shkojnë për të gjuajtur, por meshkujt hanë të parët:

MËSIMI 5: Mëso si të delegosh përgjegjësi

- Duhet të pranosh se nuk mund të bësh gjithçka ose të jesh kudo në të njëjtën kohë.
- Duhet të mësosh t'ua japësh disa detyra të tjerëve.
- Disa njerëz janë besimtarë të fiksuar pas "nëse do që çdo gjë të bëhet mirë, duhet ta bësh vetë." Për fat të keq, nëse e tepron këtu, kjo mund të sjellë tension gjaku dhe shkatërrim nervor.
- Një fakt interesant është se pavarësisht se femra gjuan, ajo e sjell prenë për mashkullin që të hajë ai i pari.
- Ajo çfarë të gjithë ne mund të mësojmë nga kjo është se dhënia e një detyre tjetrit nuk do të thotë që po u jep atyre hapësirë për të eliminuar autoritetin tënd, por kjo do të thotë që ti e njeh aftësinë e atij personi dhe e di që ai është i dobishëm dhe i rëndësishëm për organizatën.
- Një gjë që duhet të marrim parasysh është se luani mashkull nuk shtrihet dhe fle gjumë kur partnerja e tij shkon në gjueti, edhe ai ka punë që duhet të bëjë.
- Mos i delege të gjitha punët e tua që pastaj të dembelosesh gjatë tërë ditës. Kjo nuk është delegim detyre, por dembelizëm dhe një veprim i tillë çon në mungesë respekti.

Si të krishterë, ne duhet të jemi "të kontrolluar nga Fjala dhe të udhëhequr nga Fryma", por gjithashtu mund të mësojmë mësim të vlefshme edhe nga ajo që "bota" ka mësuar mbi "lidershipin", duke ruajtur ende urtësinë dhe standardet biblike.

Në fjalën e Perëndisë ne shohim se "vaji i vajosjes" që derdhej mbi kokën e një lideri rridhte poshtë tek trupi. E përkthyer thjesht kjo do të thotë se çdo gjë tek liderishi (i krishterë ose botëror), përfundimisht do të rrjedhë poshtë mbi punëtorët, qofshin gjëra pozitive ose negative, të mira apo të këqija.

2. Karakteristikat e lidershit.

(Lidershipi i keq, liderishi jo-guximtar ose liderishi frikacak)

1. Thuaj atë që njerëzit duan të dëgjojnë.

- Mund të thuash, "Do të mendohem për këtë" më mirë se "Jo". Edhe kjo është një përgjigje.
- Këta lidera i thonë diçka një personi dhe diçka tjetër dikujt tjetër.
- Ata duan që të gjithë t'i pëlqejnë.



2.05 - Lidershipi si luan

2. Shmang konfliktin.

- Në çdo marrëdhënie do të ketë konflikt.
- Është e nevojshme për forcën e marrëdhënieve dhe të organizatës.
- Kur lideri e shmang konfliktin, e gjithë organizata do ta shmangë atë.
- Problemet nuk trajtohen kurrë dhe prandaj nuk gjendet asnjë zgjidhje.

3. Asnjëherë i gatshëm për të marrë vendime të vështira.

- Liderat nuk duhet të jenë të zgjuar ose me përvojën më të madhe.
- Liderat marrin vendime që askush tjetër nuk është i gatshëm t'i marrë.

4. Shtiret sikur çdo gjë është në rregull, edhe kur nuk është.

- Ata shmangin problemet e vërteta.
- Ata nuk pranojnë të përballen me to.
- Ata ose nuk e dinë se si ta bëjnë këtë ose krenaria e tyre i pengon.

5. Braktis skuadrën kur gjërat bëhen të vështira.

- Nëse lideri largohet nga një situatë e vështirë, kështu do të bëjë edhe skuadra.
- Liderat e mëdhenj janë në vijën e frontit gjatë ditëve më të vështira.

6. Refuzon të mbështesë anëtarët e skuadrës.

- Askush nuk dëshiron t'i shërbejë dikujt që nuk do t'i mbrojë ata.
- Njerëzit duhet ta dinë që nëse bëjnë gabime, lideri i tyre do t'i mbështesë dhe mund t'i ndihmojë.

7. Trembet nga kritika.

- Për çdo vendim një lider do të marrë kritika.
- Liderat e këqij rrëzohen, njerëzit ankohen.
- Ata e marrin atë personale dhe refuzojnë të shohin ndonjë vlerë në të.
- Këta lidera e shohin çdo kritikë si një kërcënim kundër lidershipit të tyre.

8. Bëjnë goditje pas kurrizit.

- Vazhdimisht flasin keq për punëtorët ose eprorët e tyre.
- Në mungesë të respektit dhe vetëpërmbytjes, si rezultat këta lidera do të humbasin autoritetin e tyre moral për të udhëhequr.

9. Shmang punën.

- Kur puna bëhet e vështirë, ata zhduken.
- Kur liderat shmangin ose delegojnë detyrën e tyre, ata dërgojnë një mesazh të qartë: ti je i vetëm në këtë gjë.

10. Që nuk dëgjon.

- Ata janë kaq superiorë ... ose kështu mendojnë.
- Ata i ndërpresin njerëzit për të shmangur një diskutim.
- Këta lidera duan t'u dalë gjithmonë e tyrja.
- Aty ku punonjësit nuk kanë të drejtë të flasin, ata nuk kanë asnjë interes apo pohim për këtë situatë.

11. Ka frikë të disiplinojë.

- Shumica e liderëve nuk e kanë problem për të shkuar pas atyre punonjësve të pakënaqur.
- Ndonjëherë, për të qenë të guximshëm, liderat duhet të disiplinojnë miqtë e tyre, ata që kanë mështetur karrierën e tyre dhe i njohin sekretet e tyre.



2.05 - Lidershipi si luan

12. Nuk e çojne punën në fund

- Duket sikur asgjë nuk bëhet.
- Sigurisht, ata kanë gjithmonë justifikime.
- Liderat që "dëshirojnë të jenë të tillë" janë fillestarë.
- Liderat e vërtetë janë njerëz që i përfundojnë gjërat.

13. Nuk mendojnë për veten e tyre.

- Shpesh, liderat fshihen në mesin e njerëzve duke pritur që të tjerët të gjejnë zgjidhje.
- Ata besojnë se uniformiteti është i barabartë me sigurinë, duke qëndruar në dhe me turmën e njerëzve.
- Këta lidera mbështeten tek rregullat, struktura dhe nderimi.

14. Fshihen pas fuqisë.

- Si lidera ata kanë shtatin që u jep titulli.
- Për më tepër, ata shfrytëzojnë qindra njerëz për të realizuar qëllimet e tyre.
- Por çfarë ndodh kur liderat ndihen të mbingarkuar dhe të kërcënuar?
- Si e përdorin ata fuqinë e tyre dhe aparatit që ata kontrollojnë?

15. Nuk rritet dhe nuk ndryshon.

- "Nuk dua ta dëgjoj." A ka një frazë më të keqe që mund të thotë një lider?
- Kur liderët bëhen të sigurtë për pikat e tyre të forta, pikërisht atëherë këto pikat e forta bëhen pika të dobëta.
- Lidershipi kërkon përlësinë për të parë se alternativat nuk janë kërcënime.
- Dhe kërkon një ndërgjegjësim për të dalluar interesat më të mira të kompanisë nga interesat e veta.

16. Nuk është autentik.

- Pak gjëra mund të diskreditojnë një lider më shpejt sesa të perceptohen si hipokritë.
- Dhe ata formojnë një skuadër që i mungon guximi për të mirëbesuar dhe respektuar njëri-tjetrin.

17. Nuk krijon shoqëri me njerëzit e tjerë:

- Marrëdhëniet me të tjerët kanë nevojë që ne të dalim nga vetja, të bëhemi të prekshëm dhe të dalim se kush jemi me të vërtetë.
- Liderat i shtojnë tutje ata njerëz të ashpër dhe të largët, dhe mospërfillin njerëzit për të penguar çdo ndërveprim.
- Duke vepruar kështu, ata nuk lidhen ose nuk mësojnë se çfarë i motivon njerëzit e tyre.
- Si rezultat, këta lidera kurrë nuk marrin maksimumin prej tyre. Marrëdhëniet kërkojnë kohë.

18. Nuk pranojnë dështimin.

- Ata zvarriten në një guaskë. Ata përpiqen ta mbulojnë atë.
- Kur kjo dështon, ata fajësojnë të tjerët ose shmangen. Disa këmbëngulin dhe bëhen më të mençur.
- Të tjerë mbesin në vend duke përsëritur të njëjtat gabime.
- Disa thjesht heqin dorë, duke fajësuar kohën, rrethanat dhe fatin.

19. Pranojnë vetëm fuqinë, jo njerëzit.

- Stili i lidershipit është transaksional ose pozicional: Motivët janë egoiste dhe të pandershme.
- Nuk shqetësohen për mirëqenien e askujt tjetër.
- Dëshira për pushtet çon në përdorimin e mashtrimit.
- Stili i lidershipit është manipulues
- për të arritur dhe ruajtur fuqinë absolute.



2.05 - Lidershipi si luan

20. Pa vizion për përparimin e njerëzve.

- Nuk duan të bëjnë ndryshimet e nevojshme për të ndihmuar komunitetin.
- Shqetësohen vetëm për pozitën e tyre.
- Kur aftësia e tyre vihet në pikëpyetje ata dalin me justifikime ose fajësojnë të tjerët për dështimet e tyre.
- Rezultati i këtij lloji lidershipi çon në tension dhe zhgënjim.

3. Karakteristikat e lidershipit. **(Lidershipi i mirë ose i guximshëm)**

Guximi i vërtetë është një mentalitet që reflektohet në jetën tonë të përditshme nga veprimet dhe vendimet tona dhe jo vetëm nga ajo që ne themi. Kjo kërkon ndërgjegjësim, sinqeritet dhe këmbëngulje, një vendim zemre! Sepse, ashtu si dikush mendon në zemër të tij, ashtu është ai... (Fjalët e urta 23: 7

1. Liderat e mirë e kuptojnë rrethin e jetës.

- Ata e kuptojnë përgjegjësinë dhe kufijtë e juridiksionit të tyre.
- Ata e kuptojnë "Rrethin e Jetës" dhe sigurohen që njerëzit e tyre janë të edukuar siç duhet, sipas pritshmërive të një organizate të sukseshme.

2. Liderat e mirë përdorin lidershipin transformues.

- Ata tregojnë lidershipin transformues duke ndihmuar njerëzit të transformohen në potencialin e tyre të plotë.
- Ata nuk përdorin forcë ose manipulime, por sigurojnë disiplinë dhe dashuri të pakushtëzuar.
- Ata mësojnë të jenë të durueshëm dhe të kuptueshëm. Ata janë të gatshëm të investojnë kohë dhe përpjekje në liderë të mundshëm.

3. Liderat e mirë shfaqin lidershipin motivues;

- Ata shfaqin aftësi lidershipi motivues ndaj njerëzve të tyre.
- Ata inkurajojnë njerëzit të jenë të fortë dhe të guximshëm.
- Sa herë që inkurajojmë të tjerët, ata bëhen të vetësigurtë dhe fitojnë respekt për veten e tyre.

4. Liderat e mirë punojnë në një proces zhvillimi.

- Lidershipi nuk është një shfaqje e pushtetit, por një proces i zhvillimit dhe disiplinës.
- Ne nuk mund të varemi gjithmonë nga dikush tjetër që të bëjë gjithçka për ne dhe as nuk duhet të presim që mentorët tanë do të jenë gjithmonë aty për ne.

5. Udhëheqësit e mirë i dinë përgjegjësitë dhe detyrat.

- Ata bëhen të vetëdijshëm për përgjegjësitë dhe detyrat që janë të nevojshme dhe i përmbushin ato.
- Ata i pranojnë ato pa ankesa.

6. Liderat e mirë zbulojnë identitetin dhe potencialin e tyre.

- Ata nuk janë më skllëvër të së kaluarës së tyre, por bëhen të rritur.
- Ata janë të gatshëm të përballen me refuzimin, konfrontimin dhe pasigurinë.
- Ata janë të guximshëm në momentin e duhur dhe ngrihen për të shfaqur karakteristikat e vërteta të një lideri.

7. Liderat e mirë bëhen shembull për të tjerët.

- Ata e kuptojnë se janë duke vepruar si një shembull për të tjerët.
- Komplimenti më i madh për një lider është kur njerëzit pyesin se çfarë do të bënte shembulli im model në këtë rast?



2.05 - Lidershipi si luan

8. Liderat e mirë tregojnë integritet.

- Integriteti është përputhshmëria mes asaj që thua dhe asaj që bën, si dhe mes asaj që thua për atë që ke bërë. Integriteti është PARIMI BAZË i lidershipit.

Një fjalë e fundit në lidhje me lidershipin

Lidershipi nuk ka të bëjë me veten tënde ose çfarë mund të marr unë nga njerëzit nën lidershipin tim, ose si mund të përfitoj nga të tjerët, por është puna së bashku për të arritur objektivin ose qëllimin që është vendosur para nesh! Lidershipi i vërtetë ka të bëjë me vendosjen e të TJERËVE NË VEND TË PARË duke i ndihmuar ata të rriten dhe të zhvillohen dhe VETEN TËNDE TË FUNDIT. Kjo quhet SACRIFICË!

Një skuadër futbollit mund të ketë një kapiten dhe një zëvendëskapiten, por kjo nuk i bën ata më të mirë se anëtarët e tjerë të skuadrës, por më shumë të përgjegjshëm dhe llogaridhënës! Ata janë përgjegjës për të zhvilluar talentet dhe aftësitë e të tjerëve.

Liderat e vërtetë nuk udhëheqin me teknikat e kontrollit, dominimit, frikësimit, manipulimit apo frikës. Nëse Perëndia nuk na kontrollon ose nuk na sundon ne, atëherë as ne si lidera nuk kemi të drejtë të kontrollojmë apo dominojmë të tjerët.

JEZUSI ËSHTË ZOT!